

ISD

Powering solutions
to extremism
and polarisation



STUDIM PËR REZISTENCËN E KOMUNITETIT

KUMANOVË, MAQEDONIA E VERIUT

Simeon Dukiq, Tim Hulse, dhe Daniel Hooton

Përmbajtja

Mirënjohje	1
Abstrakt	1
Hyrje	2
Metodologjia	3
Gjetjet kryesore	4
Rekomandimet	6
Në detaje: Shqyrtimi i rezultateve dhe konkluzioneve	8
Rezistenca ndaj ekstremizmit të dhunshëm është relativisht e lartë në Kumanovë	8
Rezistenca ndaj ekstremizmit ndryshon sipas lagjeve në Kumanovë	10
Marrëdhëniet e dobëta ndërmjet banorëve të Kumanovës dhe autoriteteve qeveritare kanë një ndikim thelbësor negativ në rezistencën ndaj ekstremizmit të dhunshëm në komunë	11
Rezistenca në Kumanovë ndikohet negativisht nga mungesa e kohezionit midis komuniteteve në komunë	14
Besimi i publikut në reagimin e autoriteteve lokale, shkollave dhe institucioneve fetare ndaj ekstremizmit të dhunshëm ka një ndikim të rëndësishëm ndaj rezistencës në Kumanovë	17
Opinionet publikë është i ndarë në mënyrë të barabartë në lidhje me atë se sa me sukses autoritetet lokale, shkollat dhe institucionet fetare trajtojnë problemet sociale si mungesën e tolerancës dhe urrejtjen në Kumanovë	18
Qytetarët e Kumanovës kanë një vetëdije të kufizuar për organet e krijuara për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm në komunë	20
Ka shumë të ngjarë që qytetarët në Kumanovë të drejtohen tek autoritetet lokale dhe policia kur ata përjetojnë ose dëshmojnë diskriminim dhe urrejtje	22
Ka shumë gjasa që njerëzit në Kumanovë të kontaktojnë autoritetet lokale dhe policinë nëse dikush të cilin ata e njohin vepron në një mënyrë urrejtëse ose diskriminuese	23
Hapat e mëtejme	24
Shtojca 1: Metodologjia: Studimi i rezistencës së komunitetit në Kumanovë	25
Shtojca 2: Instrumenti i studimit	35

Mirënjohje

Dëshirojmë të falënderojmë Institutin për Kërkime Politike - Shkup (IPRS) për profesionalizmin dhe mbështetjen e tyre gjatë zbatimit të studimit dhe analizës së rezultateve. Për më tepër, dëshirojmë t'ia shprehim vlerësimin tonë Profesor Veton Latifit, Koordinatorit tonë lokal për parandalim të SCN për aktivitetet programatike në Kumanovë, për njohuritë e tij të vlefshme që kontribuuan në këtë raport. Në mënyrë plotësuese, dëshirojmë të falënderojmë Besim Doganin, Koordinatorin tonë lokal për parandalim të SCN për mbështetjen e procesit të hartimit dhe rishikimit të përkthimit.

Duhet të theksohet se kjo pjesë u shkrua fillimisht në anglisht dhe më pas u përkthye në gjuhën maqedonase dhe shqipe. Shumë falënderime për përkthyesit tanë, Jasna Soptrajanova dhe Armend Nuhiu, të cilët arritën të përkthejnë me sukses studimin e ndërlikuar pa ia humbur asnjë kuptim. Së fundmi, ne e falënderojmë Susannah Wight për aftësitë e saj të shkëlqyera në redaktimin e kopjeve dhe Ahmad Tarek për dizajnin e bukur të dhënë këtij studimi.

Abstrakt

Si pjesë e angazhimit rajonal të Rrjetit të Qyteteve të Forta (SCN) në Kumanovë, Maqedonia e Veriut, Instituti për Dialog Strategjik zhvilloi një studim përfaqësues të popullsisë për të kuptuar më mirë dinamikën lokale të rezistencës. Rezultatet nga ky studim do të shërbejnë si një bazë provash për të përshtatur dhe synuar aktivitetet e Ekipit për veprim në komunitet (EVK) të renditura në Planin lokal për veprim të Kumanovës për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm. Për më tepër, këto të dhëna shërbejnë si një bazë e rezistencës së komunitetit, ndaj së cilës mund të vlerësohet ndikimi i masave parandaluese në komunë. Hulumtimi tregon se popullsia e Kumanovës është relativisht rezistuese, me ndryshimet më të mëdha në rezultatet e rezistencës të gjetura në moshën e një individi dhe lagjen e banimit. Hulumtimi gjithashtu tregon se rezistenca e komuniteteve në Kumanovë ndikohet më së shumti nga besimi i tyre në institucionet publike.

Hyrje

Nën programimin e tij rajonal në Ballkanin Perëndimor, (SCN) Rrjeti i Qyteteve të Forta i ISD ka bashkëpunuar me Komunën e Kumanovës për të mbështetur qasjet ndërdisiplinore dhe me shumë aktorë për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm (P/CVE). Për të arritur këtë qëllim, SCN ka lehtësuar krijimin e një rrjeti lokal për parandalim, të quajtur Ekipi për veprim në komunitet (EVK), me mandat për të zhvilluar dhe zbatuar masat e politikave për forcimin e kohezionit social dhe ndërtimin e rezistencës së komunitetit ndaj urrejtjes, polarizimit dhe ekstremizmit. Anëtarët e EVK kanë marrë pjesë në një program për ndërtimin e kapaciteteve përmes të cilit ata janë pajisur me lëndë dhe ekspertizë teknike për të zhvilluar një Plan lokal për veprim P/CVE, i cili më pas u miratua zyrtarisht nga Këshilli lokal për parandalim i Kumanovës. Aktualisht, SCN po mbështet anëtarët e EVK dhe aktorët e tjerë të interesuar lokal në zbatimin e aktiviteteve kryesore të bazuara në komunitet të cilat ofrojnë fusha dhe objektiva me prioritet të planit për veprim.

Për të siguruar vlerësim të suksesshëm, SCN zhvilloi një instrument studimi për të matur ndikimin e aktiviteteve të EVK në të gjithë komunitetin. I përbërë nga dy seksione, ai mat ndërgjegjësimin dhe qëndrimet e qeverisë lokale ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe parandalimin, dhe rezistencën e komunitetit ndaj radikalizimit. Sondazhi do të kryhet dy herë me qëllim që të konstatohen parametrat fillestar (baseline) në fillim të projektit dhe më pas parametrat përfundimtar (endline) në fazën përfundimtare të projektit me qëllim që të maten ndryshimet në rezistencën e komunitetit dhe perceptimet për ekstremizmin. Ky studim paraqet rezultatet tona themelore.

Metodologjia

Hulumtimi u krye në partneritet me Institutin për Kërkime Politike - Shkup (IPRS), një organizatë për hulumtime dhe sondazhe me qendër në Shkup, Maqedonia e Veriut. IPRS ishte përgjegjës për anketimin e një mostre të paanshme dhe përfaqësuese të individëve nga komuna e Kumanovës të moshës 15 vjeç e më lartë, përmes intervistave telefonike. IPRS grumbulloi 1,052 përgjigje të vlefshme, nga të cilat 797 u kryen në gjuhën maqedonase dhe 255 në atë shqipe. Kjo madhësi e mostrës është zgjedhur për të qenë përfaqësuese e popullatës që jeton në territorin e komunës së Kumanovës; prandaj gjetjet nga shembulli mund të zbatohen për popullatën në formë të vlerësimeve. Për më tepër, të gjitha rezultatet nga ky studim janë statistikisht të rëndësishme nëse nuk theksohet ndryshe. Intervistat telefonike u zhvilluan mes 10 dhe 25 shkurtit të vitit 2020 në të njëjtën periudhë kur EVK ishte duke planifikuar aktivitetet e saj të para për komunikimin me komunitetin. Si pasojë, rezultatet fillestare të ndonjë prej aktiviteteve të zbatuara nga Plani lokal për veprim P/CVE duhet të merren në hulumtim e parametrave përfundimtare (endline), i cili do të kryhet në korrik 2021.

Pyetësi i sondazhit përbëhet nga 30 pyetje që përfaqësojnë një përzierje të artikujve të përshtatur, të zhvilluar nga ISD, dhe një shkallë të vendosur qëndrimi të quajtur BRAVE-14. Pyetjet e porositura janë krijuar për të matur qëndrimet e komunitetit ndaj ekstremizmit dhe reagimin e qeverisë ndaj tij, ndërsa BRAVE-14 përdoret për të matur rezistencën e komunitetit ndaj radikalizimit. Në mënyrë të veçantë, BRAVE-14 është krijuar për të matur pesë aspekte të rezistencës:

- identitetin kulturor dhe lidhjen;
- kapitalin e urëzimit (lidhjes) d.m.th. besimin dhe mirëbesimin te njerëzit e grupeve të tjera;
- kapitalin e lidhjes, respektivisht besimin te figurat e qeverisë dhe ato me autoritet;
- sjelljet e lidhura me dhunën;
- dhe besimet e lidhura me dhunën.

Natyra e këtij studimi paraqet sfida të ndryshme për matjen e saktë të qëndrimeve në Kumanovë. Një listë e detajuar e kufizimeve dhe zbutjeve mund të gjendet në metodologjinë e plotë; këtu është dhënë një përmbledhje e kufizimeve kryesore të studimit dhe qasjes së SCN për zbutjen e tyre:

- Studimi mbështetet në qëndrimet e vetë raportuara ndaj temave të ndjeshme sesa në sjelljet e vëzhguara. Si rezultat, raportimi i gabuar përmes përgjigjeve të pasakta ose të pavërteta nga ata të anketuar mund të shtrembërojë të arriturat.
- Koncepti i "rezistencës ndaj ekstremizmit të dhunshëm" dhe atributet që e përbëjnë atë mbeten mjaft të kontestuar. Shkalla BRAVE-14 u zgjodh për shkak të fuqisë së kërkimit dhe evidencës së përdorur në zhvillimin e saj.
- Përshtatjet statistikore të përdorura për të korigjuar të dhënat e humbura dhe peshimin e përgjigjeve për të siguruar përfaqësim më të madh mund të kenë zvogëluar saktësinë e të dhënave duke rrezikuar vlefshmërinë e brendshme. Për të shmangur këtë rrezik, u grumbullua një mostër e gjerë e përgjigjeve nga Kumanova. Për më tepër, u realizuan teste statistikore pas përshtatjes dhe u bë një analizë paralele e të dhënave të papërpunuara, për të kontrolluar divergjencën e të dhënave origjinale dhe të kodifikuara.
- Çdo ndryshim i rezistencës në nivelin e popullsisë i prodhuar nga EVK do të shfaqet realisht për disa vjet. Pasi të përfundojë kjo fazë e përfshirjes së SCN në Kumanovë dhe pasi të kryhet studimi i linjës fundore, priten disa ndryshime në qëndrimet e komunitetit, por ka të ngjarë që ata të jenë të vogla dhe të kufizuara në nën-popullata specifike.

Gjetjet kryesore

- 1 Kumanova ka një rezistencë relativisht të lartë të komunitetit ndaj ekstremizmit të dhunshëm në bazë të pozicionit të tij në shkallën e qëndrimit BRAVE-14 me 53.49 nga gjithsej 70.** Për ta vendosur numrin në kontekst, të rinjtë në Australi dhe Kanada në këtë shkallë kanë shënuar rezultat me 53.04 dhe 51.13, përkatësisht.
- 2 Rezultatet tregojnë se vetëm demografia është një parashikues i dobët i rezistencës ndaj ekstremizmit të dhunshëm,** me gjithë ndryshimet në rezultatet e rezistencës sipas gjinisë, moshës dhe lagjes së banimit.
- 3 Në kundërshtim me bindjen e mbajtur gjerësisht se të rinjtë janë grupi më i prekshëm dhe më pak rezistues në shoqëri, rezultatet tregojnë se mesatarisht brezat e rinj (15-34 vjeç) kanë një rezultat më të lartë të rezistencës me 54.12 sesa gjeneratat e vjetra (35-69 vjeç, të moshuarit) me një rezultat 52.86.** Sidoqoftë, duhet të theksohet se grupet 20-24 vjeç ende kanë rezultatin më të ulët të rezistencës nga çdo grup-moshë tjetër me 51.62, e cila është pak më e ulët se rezultati mesatar për brezat e vjetër.
- 4 Ekziston një ndryshim i rëndësishëm në rezultatet e rezistencës në lagjet e ndryshme në Kumanovë.** Për shembull, Igo Trickovic dhe Zeleznicka morën rezultate rezistence dukshëm nën mesataren për pjesën tjetër të komunës përkatësisht 44.95 dhe 48.87. Në të kundërt, ata që jetonin në Braniteli, Jane Sandanski dhe Goce Dellçev regjistruan rezultate të rezistencës mbi mesataren e komunës.
- 5 Kapitali i lidhjes me autoritetet është çështja më e madhe midis pesë fushave të rezistencës të hulumtuara nën shkallën BRAVE-14 në Kumanovë.** Është e rëndësishme të theksohet se lidhja e kapitalit ishte më e lartë në zonat rurale sesa në ato urbane, dhe ekziston një mospërputhje e madhe midis disa lagjeve në komunë.
- 6 Kapitali i lidhjes me individë jashtë bashkësisë fetare ose etnike është gjithashtu në skajin më të ulët të pesë fushave të rezistencës, por më e lartë se kapitali që lidh.** Kjo sugjeron që komunitetet e ndryshme në Kumanovë kanë marrëdhënie më të mira me njëri-tjetrin sesa ato me autoritetet qeveritare në përgjithësi.
- 7 Mesatarisht, të rinjtë e moshës 15-34 vjeç kanë kapital më të madh lidhës me komunitetet e tjera sesa të rriturit e moshës 35-69 vjeç.** Ashtu si me rezultatin e përgjithshëm të rezistencës, grup-moshat 20-24 vjeç mbeten një skemë më e ulët me rezultatin më të ulët të kapitalit lidhës midis të rinjve, ndërsa grupet 55-59 vjeç kanë rezultatin më të ulët për të gjitha grup moshat.
- 8 Shqiptarët etnik në Kumanovë, raportuan një kapital shumë më të ulët të lidhjes se sa maqedonasit etnik dhe bashkësitë tjera etnike si serbët, romët, turqit dhe boshnjakët.** Shqiptarët shënuan 9.98 nga 15 në këtë shkallë, ndërsa maqedonasit dhe të gjitha bashkësitë tjera etnike së bashku shënuan 10.90 dhe 10.91.
- 9 Besimi i publikut ndaj reagimit të autoriteteve lokale, shkollave dhe institucioneve fetare ndaj ekstremizmit të dhunshëm ka një ndikim të rëndësishëm ndaj rezistencës në Kumanovë.** Të dhënat e sondazhit tregojnë se ekziston një korrelacion pozitiv midis besimit të publikut në aftësinë e qeverisjes vendore, shkollave dhe institucioneve fetare për të trajtuar urrejtjen dhe polarizimin dhe rezistencën e tyre.

- 10** **Opinioni publik është pothuajse i ndarë në mënyrë të barabartë për çështjen se sa mirë reagojnë autoritetet lokale, shkollat dhe institucionet fetare ndaj jo tolerancës dhe urrejtjes në Kumanovë.** Mesatarisht 37% e të anketuarve ishin të mendimit se autoritetet lokale, shkollat dhe institucionet fetare kishin reaguar në mënyrë efektive ndaj këtyre çështjeve, ndërsa 38% besonin se jo. Me përjashtim të ndryshimeve marginale në moshë dhe lagje, nuk u gjet asnjë lidhje e qartë midis veçorive socio-demografike të të anketuarve dhe qëndrimeve të tyre ndaj efektivitetit të reagimeve lokale ndaj jo tolerancës dhe urrejtjes.
- 11** **Në Kumanovë, ndërgjegjësimi i publikut për ekzistencën dhe përgjegjësitë e Këshillit lokal për parandalim (KLP) dhe Ekipit për veprim në komunitet (EVK) është i kufizuar. Përgjigjet e sondazhit, treguan se vetëm 20% e njerëzve në komunë janë të njohur me rolin e KLP dhe vetëm 16% janë të njohur me rolin e EVK.** Arsyeja më e mundshme për këto rezultate është se trupi me mandat për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në Kumanovë u formua vetëm gjashtë muaj para këtij studimi.
- 12** **Publiku në Kumanovë ka shumë të ngjarë t'u drejtohet autoriteteve lokale dhe policisë kur përjeton ose dëshmon diskriminim dhe urrejtje. 66% e të anketuarve do të shkonin në polici, e cila kryeson me një dallim të lartë ndaj opsionit të dytë më të popullarizuar, institucionet lokale, me 12%.**
- 13** **Njerëzit në Kumanovë ka shumë të ngjarë të kontaktojnë autoritetet lokale dhe policinë nëse dikush që ata e njohin vepron në një mënyrë urrejtëse ose diskriminuuese.** Ashtu si në gjetjet e mëparshme, shumica e të anketuarve (56%) zgjedhën policinë si aktorin më të përshtatshëm për t'u përballur me diskriminimin.

Rekomandimet

Në bazë të këtyre katër gjetjeve, ISD ka identifikuar një grup të qartë rekomandimesh praktike për përmirësimin e programimit lokal në Kumanovë. EVK filloi një Plan lokal për veprim P/CVE në dhjetor të vitit 2019 pas një varg aktivitetesh për ndërtimin e kapaciteteve dhe praktikave më të mira. Këto të dhëna të prodhuara nga ky studim janë me vlerë kritike në informimin e masave të saj politike dhe në shënjestrimin më të mirë të aktiviteve të ardhshme në Kumanovë.

1 Aktivitetet duhet të hartohen për të synuar në mënyrë specifike të rriturit e rrezikuar.

Plani Lokal për Veprim ka një pjesë të konsiderueshme të aktiviteve të përqendruara tek të rinjtë, veçanërisht në shkollat fillore dhe të mesme. Sidoqoftë, ky raport tregon se gjeneratat e vjetra priren të jenë më pak rezistues ndaj ekstremizmit sesa homologët e tyre më të rinj. Meqenëse detyrimi i brezave të vjetër të marrin pjesë do të jetë më sfidues, EVK duhet të gjejë vende ose përmes sektorit privat ose fushatave publike për të angazhuar këtë grup kryesor demografik.

2 Aktivitetet duhet të synojnë zonat më pak rezistuese të Kumanovës.

Vlera e shtuar nga zbatimi i programimit në lagje relativisht rezistuese do të jetë më e vogël se në vendet që kanë kthyer rezultate mesatare më të ulëta të rezistencës. Për shembull, Igo Trickovic ka rezultatin më të ulët të rezistencës, duke përfshirë një nga rezultatet më të ulëta të kapitalit lidhës dhe ndërlidhës, në mbarë Kumanovën. Si pasojë, autoritetet lokale duhet t'i japin përparësi kësaj lagje kur grumbullojnë të dhëna për të kuptuar arsyet të cilat qëndrojnë pas kësaj dinamike dhe të rrisin numrin dhe cilësinë e aktiviteve që synojnë të forcojnë kohezionin social dhe rezistencën e komunitetit në këtë zonë. Kjo nuk do të thotë që lagje të tjera më rezistuese si Braniteli dhe Jane Sandanski nuk duhet të përfshihen në aktivitetet e P/CVE, por thjesht se koha, ekspertiza dhe burimet e alokuara duhet të bazohen në shkallën e sfidës së shfaqur nga nivelet më të ulëta të rezistencës.

3 Duhet të ndërmerren hulumtime të mëtejshme për të kuptuar ndryshimet në rezistencë ndërmjet lagjeve të ndryshme në Kumanovë.

Ky studim u përpoq të vendos në kontekst gjetjet gjeografike të diskutuara më sipër. Sidoqoftë, hulumtimi përkatës primar ose sekondar nuk mund të gjendej në drejtuesit ose prirjet e lokalizuara në thellësi, të cilat mund të rrisin dobësitë ndaj ekstremizmit në qytet.

4 Aktivitetet duhet të organizohen me synim të përmirësimit të besimit të institucionet (përfshirë zbatimin e ligjit), së bashku me përpjekjet ekzistuese për të ndërlidhur bashkësitë etnike dhe fetare.

Këshilli lokal për parandalim (KLP), organi nga i cili EVK merr mandatin e tij, u krijua si një mjet për të ripërtërirë besimin ndaj policisë përmes modelit të "punës policore në komunitet", por këto rezultate tregojnë se ai nuk ka qenë plotësisht efektiv.

5 Angazhimi me komunën, shkollat dhe institucionet fetare duhet të jetë me përparësi dhe kjo duhet të publikohet mirë.

Sipas të dhënave, reagimi i autoriteteve lokale, shkollave dhe institucioneve fetare ka një ndikim të rëndësishëm në rezistencën në komunitet. Së bashku me ndërgjegjësimin e publikut për ekzistencën dhe aktivitetet e KLP dhe EVK, ky faktor përbënte 30% të ndryshimit në rezultatet e rezistencës në komunitet. Kjo duhet të shërbejë si një inkurajim për EVK që të vazhdojë të punojë për të përmirësuar parandalimin në Kumanovë, veçanërisht në shkollat lokale dhe institucionet fetare, dhe që komuna të investojë në programimin për të parandaluar dhe luftuar ekstremizmin e dhunshëm. Për më tepër, përveç ndërtimit të kapaciteteve dhe aktiviteteve të përgjithshme të parandalimit, rezultatet sugjerojnë që EVK duhet t'ua kushtojë një pjesë të kohës dhe burimeve të saj fushatave strategjike të krijuara për të rritur profilin e saj publik.

6 Institucionet civile kanë nevojë për një mandat të qartë për të trajtuar urrejtjen dhe polarizimin, duke sfiduar perceptimet e popullarizuara se policia është agjencia kryesore për ngritjen e shqetësimeve.

Rezultatet e sondazhit tregojnë se njerëzit në Kumanovë i drejtohen policisë sa herë që përjetojnë dhe dëshmojnë diskriminim nga një person që e njohin. Kjo pasqyron qasjen tepër të sigurt të kësaj çështje dhe rolin e kufizuar që institucioneve të tjera u është lejuar të luajnë në këtë fushë. Me themelimin e Komitetit kombëtar për luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe kundër terrorizmit dhe miratimin e Strategjisë dhe Planit për veprim kombëtar, kohët e fundit qeveria ka shfaqur angazhimin e saj për përfshirjen e institucioneve jo të sigurisë në këtë hapësirë dhe për miratimin e një qasje "tërë-shoqërore" ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Ky ndryshim nuk do të ndodhë brenda natës. Do të nevojitet një përpjekje e qëndrueshme nga ana e qeverisë për të drejtuar institucionet dhe për të krijuar një kulturë ku policia nuk është i vetmi institucion që merret me urrejtjen dhe polarizimin në shoqëri.

Në detaje: Shqyrtimi i rezultateve dhe konkluzioneve

1 Rezistenca ndaj ekstremizmit të dhunshëm është relativisht e lartë në Kumanovë

Sondazhi ynë zbuloi se popullata e Kumanovës ka një nivel relativisht të lartë të rezistencës, me një rezultat mesatar të rezistencës prej 53.49 në një shkallë që shkon nga 14 në 70. Rezistenca në Kumanovë u vlerësua duke përdorur shkallën BRAVE-14, e cila mat rrezikun dhe faktorët mbrojtës në pesë fushat që konsiderohen të rëndësishme për rezistencën siç është përshkruar në metodologjinë e mësipërme. Të anketuarve iu kërkua të vlerësonin sa ishin dakord me 14 deklaratat qëndrimi në një shkallë prej 5 pikësh. Rezultatet e të anketuarve në 14 deklaratat në shkallën Likert u kombinuan më pas, me rezultate më të larta të përgjithshme që tregojnë nivele më të mëdha të veçorive të lidhura me rezistencën ndaj ekstremizmit të dhunshëm.

Kontekstualizimi dhe krahasimi i rezultatit mesatar të rezistencës së Kumanovës ndaj qyteteve ose vendeve të tjera është i vështirë për një numër arsyesh. BRAVE-14 u testua fillimisht me audiencë më të vogla të të rinjve në Kanada dhe Australi sesa me mostra përfaqësuese të popullsisë. Ndërsa masa është përdorur në një varg kontekstesh të tjera, ka shumë pak të dhëna publike të disponueshme për krahasim. Edhe atje ku mund të arrihen të dhënat, rezultatet e rezistencës nuk janë të krahasueshme. Gjithmonë do të ketë ndryshime në mënyrën se si audiencë u përgjigjet artikujve të caktuar në shkallë bazuar në faktorë kontekstual që mund të mos lidhen me rezistencën e tyre ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Si rezultat, BRAVE-14 është më i dobishëm për identifikimin e variacioneve të rezistencës midis grupeve socio-demografike ose pikave në kohë brenda popullatave të përcaktuara. Sidoqoftë, një krahasim me rezultatet mesatare të rezistencës midis të rinjve të anketuar në Kanada dhe Australi tregon se Kumanova ka nivele afërsisht të ngjashme të rezistencës me të anketuarit në këto vende; 53.49 në Kumanovë krahasuar me 53.04 në Australi dhe 51.13 në Kanada.¹

Rezultati i Kumanovës në shkallën BRAVE-14 është domethënës në kontekstin e historisë së dhunës dhe ekstremizmit në qytet. Kumanova është qyteti i dytë më i madh në Maqedoninë e Veriut pas kryeqytetit të Shkupit, me një përbërje të përzier etnografike që kryesisht i ngjan demografisë në të gjithë vendin. Banorët e saj formojnë një komunitet shumë kulturor me përfaqësues nga prejardhje të ndryshme etnike, fetare dhe kulturore. Në pika të ndryshme, ky tipar është provuar të jetë njëkohësisht një forcë dhe një dobësi. Më 9-10 maj 2015, Kumanova dëshmoi një betejë të armatosur midis forcave qeveritare dhe një grupi paramilitar me të dyshuar të lidhur me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, e cila e shndërroi lagjen kryesisht shqiptare etnike të Kumanovës Divo Naselje (Lagja e trimave) në një zonë konflikti.² Ngjarja rezultoi në 22 viktima, nga të cilat 8 ishin policë të shtetit (me prejardhje të përzier etnike) dhe 14 militantë sulmues. 37 oficerë tjerë u plagosën dhe 30 anëtarë të grupit militant u arrestuan me akuza të lidhura me terrorizmin.³ Ndërsa luftimet po vazhdonin, banorët me prejardhje të ndryshme etnike në Kumanovë, përfshirë kryetarin aktual të komunës, dolën në rrugë për të dërguar një porosi të unitetit dhe solidaritetit pavarësisht identitetit të tyre.⁴ Ngjarja e përgjakshme nuk ka çuar në ndonjë incident tjetër të dhunshëm në komunë, por kjo nuk do të thotë që profili i kërcënimit të qytetit është i ulët. Banorët nga qyteti kanë gjetur rrugën e tyre në fushat e betejës në Siri duke u bashkuar me grupet selefiste - xhihadiste si luftëtarë të huaj terroristë, disa prej të cilëve janë burgosur për herë të dytë pas vuajtjes së dënimit me burg për pjesëmarrje në njësi të huaja (para) ushtarake dhe/ose (para) policore.⁵ Për më tepër, kujtimet dhe ankesat që rrjedhin nga konflikti i vitit 2001 në Maqedoninë e Veriut mbeten të fuqishme në mesin e komunitetit, jo vetëm për shkak se në territorin e vetë komunës u zhvilluan një numër operacionesh ushtarake.

¹ Grossman, M., Hadfield, K., Jefferies, P., Gerrand, V., & Ungar, M. (2020), Youth resilience to violent extremism: development and validation of the BRAVE measure. *Terrorism and Political Violence* („Rezistenca e të rinjve ndaj ekstremizmit të dhunshëm, zhvillimi dhe vërtetimi i matjes BRAVE. Terrorizmi dhe dhuna politike”) <https://www.tandfonline.com/doi/abs/10.1080/09546553.2019.1705283>.

² BBC News (2015) ‘Macedonia blames Kosovans for deadly Kumanovo clashes’, 10 Maj, <https://www.bbc.co.uk/news/world-europe-32680904>

³ BBC News (2015) ‘Macedonia charges 30 with terrorism after Kumanovo clashes’, 11 Maj, <https://www.bbc.co.uk/news/world-europe-32695909>

⁴ YouTube (2015) ‘Albanian in Kumanovo speaks the truth’, 11 Maj, <https://www.youtube.com/watch?v=3J0cGFWSkJM>

⁵ Al Jazeera (2020) ‘Maqedonia arreston tre meshkuj nën dyshimin e komplotit të sulmit’, 1 Shtator, <https://www.aljazeera.com/news/2020/9/1/north-macedonia-arrests-three-men-on-suspicion-of-plotting-attack>

Analiza socio-demografike

Rezultatet e studimit tregojnë se rezistenca e popullsisë së Kumanovës bazohet në një sërë faktorësh duke përfshirë disa veçori socio-demografike si gjinia, grup-mosha dhe lagjja e banimit. E marrë vetëm, megjithatë, demografia ende u gjet të ishte një parashikues i dobët i rezistencës ndaj ekstremizmit të dhunshëm.

- Rezultatet e sondazhit sugjerojnë se **femrat në Kumanovë janë përgjithësisht më të qëndrueshme ndaj ekstremizmit të dhunshëm sesa homologët e tyre meshkuj**. Rezultati mesatar i rezistencës midis grave ishte 54.12 nga 70, 1.26 pikë më i lartë se tek meshkujt në komunë që kishin një rezultat mesatar prej 52.86. Ky zbulim përputhet me hulumtimet e tjera të kryera duke përdorur shkallën BRAVE-14 në Australi dhe Kanada, ku gratë gjithashtu u gjetën të ishin më rezistues se burrat.⁶
- Në ndryshim nga narrativet popullore rreth cenueshmërisë së të rinjve ndaj ekstremizmit të dhunshëm, rezultatet nga sondazhi sugjerojnë se **të rinjtë nën moshën 35 vjeç në Kumanovë janë në të vërtetë pak më të qëndrueshëm sesa grup-moshat e vjetra**. Rezultati mesatar i rezistencës për ata të moshës 15 - 34 ishte 54.15 nga 70 krahasuar me 52.84 për ata të moshës 35 - 69. **Një përjashtim nga kjo tendencë ishte një gamë më specifike e grupit 20 deri 24 vjeç, të cilët kishin rezultatin më të ulët të rezistencës të të gjitha grupeve të moshës, pak më poshtë se grup-moshat 35-69 në 51.62 (Figura 1).**




FIGURA 01 Rezultati i rezistencës ndaj ekstremizmit të dhunshëm të banorëve të Kumanovës, sipas grup moshave, 2020

- Nuk u gjet asnjë ndryshim i rëndësishëm në rezultatet e rezistencës së të anketuarve për përkatësinë etnike, arsimimin ose llojin e vendbanimit.
- Derisa rezultatet e rezistencës luhatnin për veçori të caktuara socio-demografike, rezultatet e studimit sugjerojnë **se demografia si e vetme është një parashikues i dobët për rezistencën ndaj ekstremizmit të dhunshëm në Kumanovë**. Vetëm gjinia, mosha dhe lagjja e banimit ishin të lidhura në mënyrë të konsiderueshme me ndryshime në rezistencën e përgjithshme dhe madje edhe kur merren së bashku këta faktorë shpjeguan më pak se 10% të ndryshimit në rezultatet e rezistencës. **Prandaj, derisa mund të përfundojmë se meshkujt në Kumanovë janë mesatarisht më pak të qëndrueshëm sesa femrat, thjesht të qenit mashkull në asnjë mënyrë nuk garanton që një individ do të jetë më i prekshëm nga ekstremizmi i dhunshëm.**

⁶ Grossman et al. (2020). Youth resilience to violent extremism'

2 Rezistenca ndaj ekstremizmit të dhunshëm sipas vendbanimeve në Kumanovë

Edhe pse popullata e Kumanovës ka nivele mesatarisht të larta të rezistencës ndaj ekstremizmit të dhunshëm, ka lagje në komunë që regjistruan nivele të rezistencës dukshëm më të larta ose më të ulëta se mesatarja. Rezultati mesatar i rezistencës në të gjithë Kumanovën ishte 53.49. **Sidoqoftë, lagjet si Igo Trickoviç dhe Zhelezniçka morën rezultate të rezistencës shumë më poshtë se kjo shifër dhe se pjesa tjetër e komunës përkatësisht 44.95 dhe 48.87.** Përkundër kësaj, ata që jetojnë në Braniteli (57.21), Jane Sandanski (56.16) dhe Goce Dellçev (55.98) kanë disa nga rezultatet më të larta të rezistencës në Kumanovë (Figura 2).




FIGURA 02 Rezultati i rezistencës ndaj ekstremizmit të dhunshëm të banorëve të Kumanovës, sipas lagjeve, 2020

Literatura aktuale nuk ofron ndonjë pasqyrë se pse disa nga këto lagje kanë rezultate veçanërisht të larta ose më të ulëta të rezistencës. Igo Trickovic është një lagje jashtëzakonisht e vogël në periferi të qytetit, e banuar kryesisht nga familje që kanë emigruar nga pjesa lindore e vendit. Zeleznicka është në rrethinat e brendshme të Kumanovës, ku jetojnë familje më të varfra nga ana sociale. Goce Dellçev dhe Braniteli janë kryesisht lagje etnike maqedonase më të dëshiruara të Kumanovës për banim, që nga shpërbërja e ish Jugosllavisë. Nga ana tjetër Jane Sandanski konsiderohet të jetë e banuar nga individë të cilët kanë ardhur nga fshatrat veriore përreth Kumanovës dhe është e përbërë nga familje më të pafavorshme shoqërore. Kjo lagje përbëhet kryesisht nga maqedonas etnikë dhe komunitete rome. Sidoqoftë, këto njohuri kryesisht anekdotike nuk janë mjaft të fuqishme për të lejuar dikë të nxjerrë përfundime domethënëse mbi ndryshimin në rezultatet e rezistencës midis lagjeve. Duhet të bëhen kërkime shtesë në këtë fushë për të kuptuar ndryshimet në dinamikën e rezistencës hiper-lokale.

3 Marrëdhëniet e dobëta ndërmjet banorëve të Kumanovës dhe autoriteteve qeveritare kanë një ndikim thelbësor negativ në rezistencën ndaj ekstremizmit të dhunshëm në komunë

Siç është përshkruar në metodologji, shkalla BRAVE-14 mat rezistencën në pesë fusha. Nga këto, identiteti kulturor dhe lidhja, sjelljet që lidhen me dhunën dhe besimet që lidhen me dhunën kthejnë rezultate të forta të rezistencës në Kumanovë. Lidhja e kapitalit me autoritetet, gjithsesi, ktheu një rezultat mesatarisht më të ulët se cilido nga fushat e tjera të rezistencës, prej 8.23 nga 15. Rezultatet e përgjithshme për secilën nga nën-shkallët vlerësohen nga 3 deri në 15 me rezultate më të larta që tregojnë nivelet më të mëdha të secilit atribut në popullatë (Figura 3).⁷ Nën-shkalla për kapitalin e lidhjes me autoritetet vlerëson: besimin e individëve dhe besimin tek qeveria dhe figurat e autoritetit; qasjen e tyre të perceptuar në institucione; dhe aftësinë e tyre për të kontribuar ose për të ndikuar në vendimmarrjen në komunitetet e tyre.




FIGURA 03 Nën-rezultatet e rezistencës ndaj ekstremizmit të dhunshëm të banorëve të Kumanovës, nga fusha e qëndrueshmërisë BRAVE-14, 2020 **Fushat e rezistencës të BRAVE- 14**

Rezultati i ulët i kapitalit lidhës i vërejtur në Kumanovë nuk është për t'u habitur duke pasur parasysh ngjarjet e fundit në Maqedoninë e Veriut. Në 2015, vendi përjetoi një krizë të rëndësishme politike pas një skandali përgjimi në të cilin shërbimet e inteligjencës nën ish-partinë në pushtet VMRO-DPMNE mbikëqyrën dhe regjistruan fshehurazi thirrje në më shumë se 20,000 numra telefoni midis 2007 dhe 2013.⁸ Skandali dëmtoi ndjeshëm besimin në qeveri dhe legjitimitetin e institucioneve. Ekspertët e komisionit të BE-së udhëzuan të raportojnë mbi çështjet e sundimit të ligjit pasi që lëshimi i përgjimeve të komunikimit gjeti një mungesë mbikëqyrjeje mbi funksionet e ish shërbimit të inteligjencës (UBK) dhe përfshirje të drejtpërdrejtë të zyrtarëve të lartë të qeverisë dhe partisë në pushtet në:

*"mashtrim zgjedhor, korrupsion, abuzim të shtetit dhe autoritetit, konflikt interesi, shantazh, zhvatje (presion mbi punonjësit publik për të votuar për një parti të caktuar ose të përballen me humbjen e punës), dëm penal, shkelje të rënda të procedurave të prokurimit që synojnë përfitim të paligjshëm, nepotizëm dhe miqësi."*⁹

⁷ Nën-shkalla për sjelljet e lidhura me dhunën përbëhej nga dy deklaratat për një rezultat të përgjithshëm prej 10, por është rregulluar në një interval prej 3 deri në 15 për krahasim më të lehtë.

⁸ R. Lyman (2015) 'Tiny Macedonia confronts a supesize scandal', New York Times, 14 Maj, <https://www.nytimes.com/2015/05/15/world/europe/tiny-macedonia-confronts-a-supesize-scandal.html>

⁹ European Country of Origin Information Network (2015) 'The former Yugoslav Republic of Macedonia: recommendations of the Senior Experts' Group on systemic rule of law issues relating to the communications interception revealed in spring 2015', 8 qershor, https://ec.europa.eu/neigh-bourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf

Pas skandalit, një qeveri e përkohshme organizoi zgjedhje të reja parlamentare në 2016, e të cilat dhanë rezultate të pavendosura. Formimi i një qeverie të re në 2017 përkoi me të ashtuquajturën 'E enjte e përgjakshme', gjatë së cilës ekstremistët e krahut të djathtë u infiltruan në parlament dhe plagosën ish politikanët e opozitës. Qeveria e re ka përmirësuar marrëdhëniet me organizatat e shoqërisë civile, ka bërë përpjekje për të rritur pavarësinë e medias dhe për të zgjidhur një numër mosmarrëveshjesh ndërkombëtare. Sidoqoftë, asgjë thelbësore nuk është bërë për forcimin e përpjekjeve për të luftuar korrupsionin e profilit të lartë, politik ose institucional në vend. Edhe më e dëmshme, 'Çështja e Zhvatjes' në vitin 2019 zbuloi se kryeprokurori i Njësisë së Prokurorisë Speciale e themeluar për të gjykuar çështje të profilit të lartë kundër veprimtarisë së pretenduar kriminale, ishte përfshirë në reket. Kjo shkatërroi besueshmërinë e njësisë dhe në fund të fundit ndikoi në vendimin për të mos rinovuar mandatin e saj.¹⁰

Sipas Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit (IPK) të lëshuar nga Transparency International, Maqedonia e Veriut renditet në vendet 106/180 me një rezultat 35/100 në 2019. Ky ka qenë rezultati më i ulët i CPI që vendi ka pasur që kur Transparency International prezantoi metodologjinë e saj të re në 2012.¹¹ Për më tepër, Freedom House e ka karakterizuar vendin si një regjim kalimtar ose "hibrid" dhe i ka dhënë një Vlerësim të Demokracisë prej 3.75/7. Rezultati i demokracisë është një mesatare e treguesve të shumtë duke përfshirë: qeverisjen demokratike kombëtare, procesin zgjedhor, shoqërinë civile, mediat e pavarura, qeverisjen lokale demokratike, kornizën gjyqësore & pavarësinë, dhe korrupsionin. Midis vendeve të Ballkanit Perëndimor, vetëm Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova kanë një rezultat më të ulët të demokracisë. Korrupsioni themelor i kombinuar me skandalet më të fundit politike ka të ngjarë të ketë pasur një efekt seriozisht të dëmshëm në besimin e publikut tek qeveria dhe mund të shpjegojë mirë kapitalin lidhës të ulët të vërejtur në Kumanovë.

Analiza socio-demografike

Derisa rezultatet mesatare për lidhjen e kapitalit mbetën më të ulëta midis pesë fushave të rezistencës në të gjitha grupet socio-demografike, disa ndryshime të prekshme lidhur me llojin e vendbanimit dhe lagjen e një individi ishin të dukshme.

- Individë nga zonat rurale në komunë demonstuan kapital lidhës pak më të lartë me autoritetet sesa ata të vendosur në qendrën urbane të Kumanovës. Kapitali lidhës ishte 9% më i lartë në zonat rurale, edhe atë në 8.87 nga 15 krahasuar me 8.06 në zonat urbane.
- Kapitali i lidhjes me autoritetet ndryshonte bazuar në lagjen në të cilën jetojnë të anketuarit. Rezultatet për lidhjen e kapitalit ndryshonin nga 6.64 në BS Gojco në 9.64 në Ajdučka Cesma, një ndryshim prej afërsisht 31%. Kapitali më i lartë lidhës u gjet në Ajdučka Česma, Jane Sandanski dhe zonat rurale përreth Kumanovës, ndërsa lagjet me kapitalin më të ulët lidhës përfshinin BS Gojco, Igo Trickovic dhe Nikola Tesla (Figura 4).

¹⁰ Freedom House (2020) 'Nations in transit 2020: North Macedonia', <https://freedomhouse.org/country/north-macedonia/nations-transit/2020>.

¹¹ Transparency International (2021) 'Corruption Perceptions Index, World map: North Macedonia', <https://www.transparency.org/en/cpi/2018/results/mkd>




FIGURA 04 Rezultati i kapitalit lidhës të banorëve të Kumanovës, sipas lagjeve, 2020

- Ashtu si në kapitullin e mëparshëm, nuk është kryer asnjë hulumtim i qasshëm publikisht që mund të shpjegojë ndryshimet në lidhjen e rezultateve të kapitalit midis lagjeve në Kumanovë. BS Gojco është afër qendrës së qytetit, ndërsa Igo Trickovic është në periferi të tij. Jane Sandanski dhe Ajducka Cesma kanë familje me të ardhura më të ulëta që kryesisht kanë migruar nga zonat rurale përreth Kumanovës në dekadat e fundit. Megjithatë, përsëri nuk ka të dhëna për këto lagje në lidhje me nivelet e burgosjes, nivelet e të ardhurave, perceptimet e korrupsionit, tendencat e votimit, etj. Do të duhet të kryhen kërkime të mëtejshme nëse dëshirohet të kuptohen plotësisht dallimet në kapitalin lidhës midis lagjeve.
- Asnjë ndryshim i rëndësishëm nuk u gjet në kapitalin lidhës të të anketuarve me autoritetet bazuar në gjininë, moshën, etninë ose arsimimin e tyre. Fakti që lidhja e rezultateve të kapitalit nuk ndryshon ndjeshëm bazuar në përkatësinë etnike sugjeron që të gjitha grupet aktualisht nuk besojnë ndaj institucioneve qeveritare në mënyrë të barabartë. Ky zbulim është i rëndësishëm duke pasur parasysh tensionet historike të shkaktuara nga mungesa e përfaqësimit etnik në institucionet publike.

4 Rezistenca në Kumanovë ndikohet negativisht nga mungesa e kohezionit midis komuniteteve në komunë

Rezultati mesatar për kapitalin lidhës me anëtarët e grupeve të jashtme ishte gjithashtu në skajin më të ulët të pesë fushave të rezistencës në 10.67 nga 15. Pohimet e artikullit për kapitalin lidhës kishin të bënin me: besimin dhe besimin e një individi tek njerëzit nga grupet e tjera; fuqinë e lidhjeve të tyre me anëtarët e komuniteteve të tjera; nëse ata ndiheshin rehat kur lidheshin me individë nga jashtë grupeve; dhe, shkallën në të cilën ata vlerësojnë harmoninë ndërmjet grupeve.

Komuna e Kumanovës është shumetnike dhe shumë-kulturore, e përbërë nga maqedonas (60,47%), shqiptarë (25,80%), serbë (6,67%), romë (5,71%) dhe grupe të tjera (1,35%). Si rezultat i këtij diversiteti, marrëdhëniet e mira midis komuniteteve janë thelbësore për paqen dhe zhvillimin. Sidoqoftë, rezultatet e ulëta të raportuara të kapitalit lidhës nuk janë të habitshme duke pasur parasysh historinë e mosbesimit dhe dhunës në Maqedonisë së Veriut midis komuniteteve të ndryshme etnike dhe fetare që përbëjnë popullsinë e saj. Tensionet etnike midis shumicës etnike maqedonase dhe pakicës etnike shqiptare kanë qenë të shquara gjatë gjithë historisë së vendit, duke arritur kulmin në konfliktin e vitit 2001. Kumanova ishte një nga skenat kryesore të konfliktit, e cila shërbeu për të përkeqësuar ose krijuar përçarje të reja midis bashkësive të ndryshme etnike. Për shembull, gjatë konfliktit, Ushtria Çlirimtare Kombëtare dyshohet se ndërpreu furnizimet me ujë për familjet në qytet duke shkaktuar një krizë humanitare. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, përfshirja etnike formon një kërkesë kryesore ligjore për institucionet publike dhe qeverisjen, dhe me përjashtim të një numri të madh incidentesh; marrëdhëniet ndëretnike kanë mbetur kryesisht paqësore. Sidoqoftë, në vend që të marrë përfitimet e kohezionit të përmirësuar shoqëror, vendi ka parë kryesisht maqedonas dhe shqiptarë etnik që organizohen në bashkësi gjithnjë e më paralele. Kjo është e dukshme në sistemin shkollor paralel, dhe shpesh të veçuar, në vendin ku nxënësit etnik maqedonas ndjekin mësim në shkollat në gjuhën maqedonase, ndërsa nxënësit etnik shqiptarë ndjekin mësim në shkollat në gjuhën shqipe. Përveç kësaj, ekziston një sistem ku nxënësit maqedonas dhe shqiptarë etnik do të shkojnë në të njëjtën shkollë, por në ndërrime të ndryshme për t'u mundësuar atyre të studiojnë në gjuhën e tyre amtare. Edhe pse që këtu është e kuptueshme që kapitali tejkalues është i ulët, sidoqoftë është domethënëse që është më i lartë sesa kapitali lidhës. **Kjo minon një supozim të përbashkët se tensionet ndëretnike janë kërcënimi më i madh për paqen dhe prosperitetin në vend, kur në fakt sondazhi ynë tregon se besimi i dobët në qeveri dhe institucione është një faktor më i rëndësishëm.**

Analiza socio-demografike

Një vlerësim i hollësishëm i të dhënave tregon se karakteristika të caktuara socio-demografike priren të shoqërohen me qëndrime të ndryshme ndaj grupeve të jashtme.

Kapitali lidhës me grupe të jashtme ka tendencë të jetë pak më i lartë tek të rinjtë sesa tek anëtarët e moshuar të popullatës. Rezultati mesatar për kapitalin lidhës në Kumanovë, për individët e moshës 15 deri 34 vjeç ishte 11.02 nga 15, krahasuar me 10.36 për ata të moshës 35 deri 69 vjeç. Përsëri 20 deri në 24 vjeçët qëndrojnë jashtë këtij trendi me kapitalin ndërlidhës të dytë më të ulët nga çdo grup në komunë (10.18 nga 15) (Figura 5).




FIGURA 05 Rezultati i kapitalit lidhës të banorëve të Kumanovës, sipas grup moshës, 2020

- Dallimi në kapitalin lidhës midis brezave të ndryshëm meriton hulumtime të mëtejshme. Individë të moshës 15 - 35 vjeç ose kanë lindur ose kanë kujtime më të hershme për periudhën kur Maqedonia e Veriut fitoi pavarësinë nga Jugosllavia dhe jetoi në paqe relative në krahasim me republikat e tjera në federatë. Ndërkohë, brezat e vjetër kanë kujtime më të gjalla të shpërbërjes së përgjakshme të vendit dhe konfliktit në 2001. Kjo është një hipotezë që mund të shpjegojë pse brezat e rinj kanë kapital më të madh urgjent se pleqtë e tyre. Sidoqoftë, nuk duhet të injorohet që në mesin e të rinjve ka një rënie të madhe në rezultatet e kapitalit ndërlidhës në mesin e 20 dhe 24 vjeçarëve. Është me rëndësi të mos injorohet kjo grup moshë, jo vetëm sepse tre luftëtarët e huaj terroristë të kthyer që u arrestuan në Kumanovë më 31 gusht të vitit 2020 për komplot të një sulmi terrorist ishin 22, 25 dhe 28 vjeç, dhe të gjithë bënë pjesë brenda këtij kufiri të moshës kur ata për së pari herë u nisën për në Siri.¹²
- Shqiptarët etnikë në Kumanovë raportuan nivele pak më të ulëta të kapitalit ndërlidhës pa grupe të jashtme sesa bashkësitë e tjera etnike në komunë. Rezultati mesatar i kapitalit ndërlidhës për shqiptarët ishte 9.98 nga 15, krahasuar me 10.90 për maqedonasit dhe 10.91 për të gjitha bashkësitë e tjera etnike (një kategori e përbërë nga serbë, romë, turq, boshnjakë, etj.) (Figura 6).




FIGURA 06 Rezultati i kapitalit lidhës të banorëve të Kumanovës, sipas përkatësisë etnike, 2020

Forcimi i kapitalit ndërlidhës midis bashkësisë etnike maqedonase dhe shqiptare ka qenë qëllimi i shumë politikave dhe masave ndërkombëtare dhe kombëtare. Sidoqoftë, tejkalimi i kapitalit ndërlidhës me grupe të jashtme mbetet relativisht i përzier në popullsinë e Kumanovës. Shqiptarët në komunë raportuan rezultate marginalisht më të ulëta të kapitalit ndërlidhës, të cilat mund të shpjegohen nga një larmi faktorësh. Një arsye mund të jetë që shqiptarët e perceptojnë (në shumë raste me korrektësi) se disa segmente të komunitetit maqedonas i shohin ata si të huaj ose si kërcënime subversive në shtetin e tyre. Edhe disa elita politike maqedonase, përfshirë ish-presidentin maqedonas, kërkesat për ta bërë shqipen gjuhë zyrtare në Maqedoninë e Veriut i perceptuan si një kërcënim për sovranitetin dhe pavarësinë e vendit.¹³

¹² Libertas (2020) 'Galeria) MPB i publikoi fotografitë e terroristëve të arrestuar të ISIS në Kumanovë,' 1 Shtator, <https://libertas.mk/galeri-a-mvr-gi-ob-avi-fotografiite-od-uapsenite-terroristi-na-isis-vo-kumanovo/>

¹³ Lajmet e VOA (2017) 'Presidenti maqedonas paralajmëron për kërcënimin shqiptar ndaj sovranitetit', 7 Mars, <https://www.voanews.com/eu-rope/macedonian-president-warns-albanian-threat-sovereignty>

Rezultate të ngjashme të kapitalit ndërlidhës midis maqedonasve dhe bashkësive të tjera etnike në Kumanovë mund të shpjegohen me faktin se rezultati i bashkuar midis "etnive të tjera" përbëhet kryesisht nga serbë, grupi i tretë më i madh etnik në Komunë. Serbët flasin një gjuhë të ngjashme me maqedonasit dhe kanë të njëjtin besim të krishterë ortodoks, i cili ka ndihmuar përpjekjet e tyre për t'u integruar në shoqëri dhe që nga ana tjetër mund të prodhojë rezultate të ngjashme të kapitalit ndërlidhës.

- Kapitali ndërlidhës midis individëve që jetojnë në zemrën urbane të Kumanovës është shumë më i lartë krahasuar me ata në zonat rurale, 10.77 kundrejt 10.29 nga 15.
- Nga ana tjetër, lagjja e banimit e individëve duket të jetë e lidhur në mënyrë të konsiderueshme me kapitalin e tyre ndërlidhës me grupet e jashtme. Rezultatet në përgjithësi ndryshonin nga 9.72 në Karposh deri në 12.03 në Braniteli, që barazohet me një rritje të kapitalit ndërlidhës me rreth 19%. Në mesin e 18 lagjeve në këtë raport, Igo Trickovic ishte një rast i veçantë me një kapital mesatar ndërlidhës prej 7.57, shumë më i ulët se zonat e tjera të komunës. Lagjet me kapitalin më të lartë ndërlidhës përfshinin Braniteli, Zelen Rid dhe Goce Delcev, ndërsa rezultatet më të ulëta u gjetën në Igo Triçkoviç, Karposh dhe Brigada e tretë sulmuese maqedonase. Në mënyrë të ngjashme, siç tregohet më lart, duhet të kryhen më shumë hulumtime për të kuptuar siç duhet arsyen se pse një pjesë e vogël e lagjeve në Kumanovë vazhdimisht tregojnë rezultate të rezistencës që bien dukshëm mbi ose nën mesataren për komunën.




FIGURA 07 Rezultati i kapitalit lidhës të banorëve të Kumanovës, sipas lagjeve, 2020

- Asnjë ndryshim i rëndësishëm nuk u gjet në kapitalin ndërlidhës të të anketuarve me grupet e jashtme sipas gjinisë ose arsimimit të tyre.

5 Besimi i publikut në reagimin e autoriteteve lokale, shkollave dhe institucioneve fetare ndaj ekstremizmit të dhunshëm ka një ndikim të rëndësishëm në rezistencën në Kumanovë

Rezultatet e sondazhit zbuluan se besimi i publikut në reagimin e autoriteteve lokale, shkollave dhe institucioneve fetare ndaj ekstremizmit të dhunshëm është një parashikues i fortë i rezistencës, me nivele më të larta të besimit të shoqëruara me rezistencë më të lartë. Qëndrimet e të anketuarve ndaj regjimeve lokale të kombinuara me vetëdijen e tyre për KLP dhe EVK shpjeguan 30% të ndryshimit në rezultatet e tyre të rezistencës, duke sugjeruar që këta tre faktorë kanë një ndikim të madh në rezistencën në Kumanovë.

Besimi në autoritetet lokale u llogarit duke përdorur një shkallë Likert prej katër pikash duke vlerësuar se sa mirë autoritetet lokale, shkollat dhe institucionet fetare në komunë trajtojnë problemet sociale si diskriminimi, jo toleranca dhe urrejtja. Përgjigjet në këtë shkallë të reagimit lokal vlerësohen nga 1 në 5, me rezultate më të larta që tregojnë besim më të madh në reagimin lokal. Siç tregon diagrami shpërndarës i Figurës 8, besimi në reagimin lokal ndaj ekstremizmit të dhunshëm është i lidhur mesatarisht me rezistencën në Kumanovë, me besim më të madh të lidhur me rezistencë më të lartë.




